

AKTI I THEMELIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SOLAR 2019 SHPK

Sot më datë 26.09.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) sipas ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, themelohet kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë vijon:

NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë është “Solar 2019” Sh.P.K (më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”).

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Abdi Toptani”, Ndërtesa “Torre Drin”, kati 4, ap. 10, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të çelë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I AKTIVITETIT

- 4.1 Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve në fushën energjetike, përfshirë por pa u kufizuar në:
- a) projektimin, ndertimin, instalimin, perdorimin, venia ne pune e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të çdo tipi e lloji, në mënyre ilustruese por jo shteruese: centralet solare (fotovoltaike ose termike), etj;
 - b) prodhimi dhe tregtimi i energjisë elektrike;



c) Veprimtari te tjera ndihmese ose plotesuese.

Për këtë qëllim, Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

4.2 Për realizimin e objektit të aktivitetit saj, Shoqëria mund të:

- a) zotërojë pjesëmarrje në shoqëri dhe sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Të importojë, eksportojë, prodhojë, tregtojë me shumicë e pakicë, mallra, produkte, makineri dhe pajisje të nevojshme, të lidhura, plotësuese apo ndihmëse për ushtrimin e aktiviteteve objekt veprimtarie.
- c) kryejë të gjitha veprimet e nevojshme apo të dobishme me qëllim apo në lidhje me, përfshirë por pa u kufizuar në: dhënie e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta apo të të tretëve, veprime juridike me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, përfshirë por pa u kufizuar në: të blejë, shesë, marrë dhe/ose japë me qera, në përdorim, me uzufukt apo shfrytëzim pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, etj., të marrë dhe japë hua, si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare dhe veprime të tjera të lidhura me objektin e aktivitetit të saj apo që mundësojnë një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve të veta apo të shoqërive dhe sipërmarrjeve në të cilat zotëron, drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, pjesëmarrje apo që i nënshtrohen kontrollit të përbashkët.

NENI 5 KAPITALI

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është i barabartë me 100 Lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota, që përfaqësojnë 100% të kapitalit, me vlerë nominale prej 100 Lekë, plotësisht i nënshkruar dhe i papaguar, i cili zotërohet nga ortakët themelues s nga ortakët sipas kontributeve të mëposhtme:

- **Ortaku Z. Andi Memi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 03.04.1979, me numër personal identifikimi (NID) H90403156W, me adresë në: Blv. Gjergj Fishta, Kompleksi Matrix, Kulla 5, Ap. 50, Tiranë, ka nënshkruar 1 (një) kuota pjesëmarrjeje, të barabartë me 51 Lekë, e barazvlefshme me 51% të kapitalit të Shoqërisë;



- **Ortaku Z. Vladimir Avrami**, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më datë 10.11.1963, me numër personal identifikimi (NID) G31110147Q, me adresë në: Rr. Nikolla Tupe, Ndertesa 1, Kati 6, Tiranë, ka nënshkruar 1 (një) kuotë pjesëmarrjeje, të barabartë me 49 Lekë, e barazvlefshme me 49% të kapitalit të Shoqërisë;
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 6.1 Në rastet kur kapitali i shoqërisë zotërohet nga më shumë se një ortak, kuotat e Shoqërisë mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakëve. Premtimi dhe/ose transferimi i kuotave të Shoqërisë në favor të palëve të treta, në çdo formë, mënyrë apo afat, e drejta e opsionit dhe/ose krijimi i të drejtave të tjera mbi këto kuota i nënshtrohet miratimit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të drejtës së parablerjes nga ortakët e Shoqërisë.

NENI 7 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas legjislacionit shqiptar, këtij Statuti dhe/ose çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet ortakëve të Shoqërisë.
- 7.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij dhe të votojë sipas të drejtave që ka pjesëmarrja e tij në Shoqëri.
- 7.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë i pajisur me autorizim me shkrim.
- 7.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në



4

përputhje me parashikimet e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe nënshkruhet procesverballi përkatës.

- 7.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori/ët ose ortakët e Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit, dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose letërporosi, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për çështjet përkatëse.
- 7.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i zgjedhur ndërmjet të pranishmëve. Në rast mosdakordësie mbledhja kryesohet nga ortaku i pranishëm zotërues i pjesëmarrjes më të lartë në kapitalin e Shoqërisë. Kryetari cakton një sekretar midis personave të pranishëm për mbajtjen e procesverballit, dhe në rast se asnjëri prej tyre nuk është dakord, cakton një person të tretë.
- 7.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 7.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 7.9 Asambleja e Përgjithshme, përveç sa parashikohet në nenin 7.10 të këtij Statuti, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm, kur ortakët e mbledhur me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 7.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve të pranishëm, kur ortakët e mbledhur me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, për çështjet e mëposhtme:
- Ndryshimet e statutit;
 - Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - Shpërndarjen e fitimeve;
 - Bashkimin, ndarjen, riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë.

- 7.11 Në rast se shoqëria mbetet me një ortak të vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të gjitha vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në procesverbal dhe në Regjistrin e Vendimeve të Ortakut të mbajtur nën kujdesin e Administratorit/ëve dhe në përputhje me nenin 81 e 90 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Të dhënat e hedhura në këtë regjistër nuk mund të tjetërsohen apo të ndryshohen.

NENI 8 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 8.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm ose nga një Këshill Administrimi i përbërë nga më shumë se një administrator, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Në rastin e emërimit të një Këshilli Administrimi, Asambleja e Përgjithshme do të plotësojë njëkohësisht statutin me rregullimin e kompetencave dhe funksionimit të tij. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë **Znj. Juna Nathanaili**, shtetase shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 12.07.1989, me numër personal identifikimi (NID) I95712073U, e caktuar në detyrë për një afat 2 vjeçar, i cili fillon nga data e këtij akti.
- 8.2 Administratori i Vetëm gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimtarinë e të tretëve që ka autorizuar.
- 8.3 Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.
- 8.4 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë.

NENI 9 KONTROLLI FINANCIAR

- 9.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në të gjitha ato raste kur emërimi konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

NENI 10 VITI FINANCIAR

- 10.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të Shoqërisë, i cili fillon në datën e themelimit të Shoqërisë dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor 2019.

NENI 11 BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI

- 11.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.3 Ne përputhje me dispozitat e ligjit, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 12 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 12.1 Dispozitat e ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare do të zbatohen në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë.

NENI 13 LIGJI I ZBATUESHËM

- 13.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut e ligjin shqiptar. Dispozitat e ligjit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky akt.

NENI 14 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE



- 14.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve apo midis ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve dhe ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, përfshirë ato të ngritura nga apo kundrejt administratorit me objekt të drejtat e lidhura me Shoqërinë, do të gjykohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


NENI 15
TË NDRYSHME

- 15.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 26.09. 2019.

ORTAKËT THEMELUESË

Z. Andi Memi



Z. Vladimir Avrami

